



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK.nr.498/2022

Datë: 27 dhjetor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 4 të Rregullores nr. 03/2022 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimin e Ekspertëve Gjyqësor, në mbledhjen 301-të, të mbajtur me datë 27 dhjetor 2022, merr këtë:

## V E N D I M

- I. Themelohet Komisioni për vlerësimin e aplikacionit të kandidatit për Ekspert Gjyqësor, në përbërjen si në vijim:
  1. Fidan Hoxha, anëtar i KGJK-së/kryetar i komisionit;
  2. Burim Shala, gjyqtar në Gjykatën e Apelit/anëtar i komisionit;
  3. Gzim Llulluni, gjyqtar në Gjykatën e Apelit/anëtar i komisionit;
  4. Fahret Vellija, anëtar i KGJK-së/anëtar i rezervë;
  5. Snezana Mihajloviq, gjyqtar në Gjykatën Themelore Gjilan/anëtare rezervë.
- II. Obligohet Komisioni që t'i propozoj KGJK-së, që të paktën dy herë brenda vitit 2023 të shqyrtoj listën e kandidatëve për ekspert gjyqësor.
- III. Komisioni ka mbështetje administrative dhe profesionale nga Njësia për Inspektim Gjyqësor.
- IV. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 dhjetor 2022.

## A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 27 dhjetor 2022, ka shpallur konkurs për certifikimin dhe emërimin e ekspertëve gjyqësor.

Në këtë takim ka themeluar Komisionin për vlerësimin e aplikacionit të kandidatit për ekspert gjyqësor, i cili është përgjegjës për shqyrtimin, analizimin dhe vlerësimin e aplikacionit të kandidatit, duke përfshirë dokumentet e bashkangjitura, konform nenit 4 Rregullores nr. 03/2022 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimin e Ekspertëve Gjyqësor, në përbërjen si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit;
- Njesisë për Inspektim Gjyqësor;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe Arkivit.

